

T.nr.30/11

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, si gjykatë e shkallës së parë, jo kontestimore, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen e shqyrtimit të trashëgimisë, pas të ndjerit [REDAKTUAR] ish nga fsh [REDAKTUAR], komuna e Ferizajt, i cili ka vdekur më [REDAKTUAR] pa e shprehur vullnetin e tij të fundit, duke vendosur sipas propozimit të pjesëmarrësit [REDAKTUAR] për shqyrtimin e trashëgimisë, pas seancës së mbajtur, më datë 01.03.2018, mori këtë:

### AKTVENDIM

Trashëgimia pas të ndjerit [REDAKTUAR] ish nga fsh [REDAKTUAR] komuna e Ferizajt, i lindur më [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] përbëhet nga pasuria e palujtëshme edhe atë:

Sipas ÇRDPP nr.16682-2016, ZK Dramjak, me numër të ngastrave: 00255-0, 00289-0, 00597-0, 00599-0, 00600-0, 00658-0 dhe 00666-0, në 1/1 të pjesës ideale dhe ÇRDPP nr.16682-2016, ZK Dramjak, me numër të ngastrave: 00254-0, 00290-0, 00399-0, 00400-0, 00650-0, 00670-2, 00670-3 dhe 00671-0, në 1/1 të pjesës ideale, të gjitha në emër të trashëgimlënësit [REDAKTUAR]

**SHPALLEN TRASHËGIMTAR:** të bijt e trashëgimlënësit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] me numër personal të lnj. [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] me numër personal të lnj. [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] me numër personal të lnj. [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], me numër personal të lnj. [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me numër personal të lnj. [REDAKTUAR] secili me nga 1/5 të pjesës ideale, në tërë pasurinë e paluajtëshme të të ndjerit.

**NUK SHPALLEN TRASHËGIMTAR:** nipi i trashëgimlënësit [REDAKTUAR] bijat e trashëgimlënësit [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], pasi që të njëjtit kanë deklaruar se heqin dorë nga pasuria e trashëgimlënësit.

Propozuesi [REDAKTUAR] lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore për shkak të gjendjes së vështirë financiare.

### Arsyetimi

Propozuesi [REDAKTUAR] më datë 27.01.2011, i ka propozuar Gjykatës Themelore në Ferizaj, shqyrtimin e trashëgimisë së të ndjerit [REDAKTUAR] ish nga fsh [REDAKTUAR], komuna e Ferizajt, i cili ka vdekur pa e shprehur vullnetin e tij të fundit, dhe i cila pas vetës ka lënë pasuri të palujtëshme të cekur më lartë, si dhe trashëgimtarë të rendit të parë ligjorë dhe sipas së drejtës së përfaqësimit.

Nga dëshmi vdekja e Shërbimit të gjendjes civile me numër 02.nr.007/2011, e datës 26.01.2011, si dhe certifikata e vdekjes me nr rendor 12/2006 dhe me numër të referencës 010, e datës. 27.01.2011, shihet se i ndjeri ka vdekur më [REDAKTUAR] dhe pas vetës ka lënë trashëgimtar të rendit të parë ligjorë dhe sipas së drejtës së përfaqësimit si dhe pasuri të palujtëshme të cekur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga deklaratat e dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor nga pjesëmarrësit, djemt e trashëgimlënsit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] si dhe [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka konstatuar se të njëjtit kanë deklaruar se e pranojnë pjesën e pasurisë trashëgimore që ju takon. Kurse nga deklaratat e dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësorë nga të bijat e trashëgimlënësi [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] si dhe të [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të dhëna tek noteri në Zagreb të Kroacisë, gjykata ka konstatuar se të njëjtat kanë deklaruar se heqin dorë në tërësi nga pjesa e pasurisë së trashëgimlënses

Gjykata pasi që vërtetoi se pjesëmarrësit janë trashëgimtarë ligjor të rendit të parë dhe sipas së drejtës së përfaqësimit, në kuptim të nenit 12 të Ligjit për Trashëgimi të Kosovës, e duke u bazuar në deklaratat e dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor, për trashëgimtarë shpall të bijtë e trashëgimlënësit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në tërë pasurinë e palujtëshme të trashëgimlënësit [REDAKTUAR] secili me nga 1/5 të pjesës ideale.

Pjesëmarrësit, në konsultim me gjykatën kanë vlerësuar se e tërë masa e pasurisë në rastin konkret ka vlerë diku rreth 10.000 € dhe gjykata për shkak të gjendjes së vështirë financiare të propozuesit të njëjtin e liroj nga pagesa e taksës gjyqësore.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
T.nr.30/11, më datë 01.02.2018

**GJYQTARI**  
Faton Ajvazi

*Faton Ajvazi*

**Këshilla juridike:** Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit të Kosovës.



T.nr.30/11

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, si gjykatë e shkallës së parë, jo kontestimore, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen e shqyrtimit të trashëgimisë, pas të ndjerit [REDAKTUAR] ish nga fsh [REDAKTUAR] komuna e Ferizajt, i cili ka vdekur më [REDAKTUAR], pa e shprehur vullnetin e tij të fundit, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, për përmirësimin e gabimit teknik, në arsyetimin e aktvendimit T.nr.30/11, të datës 01.03.2018, më datë 09.03.2018, mori këtë:

### AKTVENDIM

**BËHET PËRMIRËSIMI** i gabimit teknik në pasuesin e tretë (3) të dispozitivit të aktvendimit T.nr.30/11, të datës 01.03.2018, në pasuesin e parë (1), të tretë (3) dhe të katërt (4), në të cilët është shënuar gabimisht:

**SHPALLEN TRASHËGIMTAR:** të bijt e trashëgimlënësit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] me numër personal të Inj. [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] me numër personal të Inj. [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] me numër personal të Inj. [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] me numër personal të Inj. [REDAKTUAR], dhe [REDAKTUAR] me numër personal të Inj. [REDAKTUAR] secili me nga 1/5 të pjesës ideale, në tërë pasurinë e paluajtëshme të të ndjerit, ashtu që pasuesi i tretë (3) i dispozitivit të aktvendimit T.nr.30/11, të datës 01.03.2018, duhet të jetë:

**SHPALLEN TRASHËGIMTAR:** të bijt e trashëgimlënësit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] me numër personal të Inj [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] me numër personal të Inj [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] me numër personal të Inj [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] me numër personal të Inj [REDAKTUAR], ([REDAKTUAR] me numër personal të Inj [REDAKTUAR]), e trashëgon vetëm pjesën që do t'i takonte të ndjerit [REDAKTUAR] djal i trashëgimlënësit), secili me nga 1/5 të pjesës ideale, në tërë pasurinë e paluajtëshme të të ndjerit.

Gjithashtu **BËHET PËRMIRËSIMI** i gabimit teknik në pasuesin e parë (1), të tretë (3), dhe të katërt (4), të arsyetimit të aktvendimit T.nr.30/11, të datës 01.03.2018, në të cilin është shënuar gabimisht:

Propozuesi [REDACTED] më datë 27.01.2011, i ka propozuar Gjykatës Themelore në Ferizaj, shqyrtimin e trashëgimisë së të ndjerit [REDACTED] ish nga fsh [REDACTED] komuna e Ferizajt, i cili ka vdekur pa e shprehur vullnetin e tij të fundit, dhe i cila pas vetës ka lënë pasuri të palujtëshme të cekur më lartë, si dhe trashëgimtarë të rendit të parë ligjorë dhe sipas së drejtës së përfaqësimit.

Nga deklaratat e dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor nga pjesëmarrësit, djemt e trashëgimlënsit [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] si dhe [REDACTED] në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka konstatuar se të njëjtit kanë deklaruar se e pranojnë pjesën e pasurisë trashëgimore që ju takon. Kurse nga deklaratat e dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësorë nga të bijat e trashëgimlënësi [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] dhe [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] si dhe të [REDACTED] dhe [REDACTED] të dhëna tek noteri në Zagreb të Kroacisë, gjykata ka konstatuar se të njëjtat kanë deklaruar se heqin dorë në tërësi nga pjesa e pasurisë së trashëgimlënses

Gjykata pasi që vërtetoi se pjesëmarrësit janë trashëgimtarë ligjor të rendit të parë dhe sipas së drejtës së përfaqësimit, në kuptim të nenit 12 të Ligjit për Trashëgimi të Kosovës, e duke u bazuar në deklaratat e dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor, për trashëgimtarë shpalli të bijtë e trashëgimlënësit [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] në tërë pasurinë e palujtëshme të trashëgimlënësit [REDACTED], secili me nga 1/5 të pjesës ideale.

**ashtu që pasuesit e cekur më lart duhet të jenë:**

Propozuesi [REDACTED] më datë 27.01.2011, i ka propozuar Gjykatës Themelore në Ferizaj, shqyrtimin e trashëgimisë së të ndjerit [REDACTED] ish nga fsh [REDACTED] komuna e Ferizajt, i cili ka vdekur pa e shprehur vullnetin e tij të fundit, dhe i cila pas vetës ka lënë pasuri të palujtëshme të cekur më lartë, si dhe trashëgimtarë të rendit të parë ligjorë dhe sipas së drejtës së përfaqësimit.

Nga deklaratat e dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor nga pjesëmarrësit, djemt e trashëgimlënsit [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] si dhe [REDACTED] në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka konstatuar se të njëjtit kanë deklaruar se e pranojnë pjesën e pasurisë trashëgimore që ju takon. Kurse nga deklaratat e dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësorë nga të bijat e trashëgimlënësit [REDACTED] e gjinisë [REDACTED]

██████ dhe ██████ e gjinisë ██████ gjykata ka konstatuar se të njëjtat kanë hequr dorë në tërësi nga pjesa e trashëgimisë që do t'iu takonte si dhe gjykata gjithashtu konstaton se ██████ dhe ██████, në deklaratat e dhëna tek noteri në Zagreb të Kroacisë të cilët janë trashëgimtar të të ndjerit ██████ i biri i trashëgimlënsit kanë deklaruar se heqin dorë nga pjesa e pasurisë së trashëgimlënsit që do të ju takonte, në dobi të pjesëmarrësit, trashëgimtarit ██████

Gjykata pasi që vërtetoi se pjesëmarrësit janë trashëgimtarë ligjor të rendit të parë dhe sipas së drejtës së përfaqësimit, në kuptim të nenit 12 të Ligjit për Trashëgimi të Kosovës, e duke u bazuar në deklaratat e dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor si dhe të deklaratave të dhëna tek noteri në Zagreb R e Kroacisë, për trashëgimtarë shpalli të bijtë e trashëgimlënsit ██████ dhe ██████ i cili e trashëgon vetëm pjesën që do t'iu takonte trashëgimtarit ██████ ngase pjesëmarrësit ██████ dhe ██████ kanë hequr dorë nga pjesa e trashëgimisë që do tu takonte në dobi të trashëgimtarit ██████ në tërë pasurinë e paluajtshme të trashëgimlënsit ██████ secili me nga 1/5 të pjesës ideale.

Në pjesët tjera në hyrje, dispozitiv dhe në arsyetim, aktvendimi mbetet i pandryshuar.

Aktvendimi t'iu dërgohet pjesëmarrësve, trashëgimtarëve.

#### A r s y e t i m

Gjykata me aktvendimin T.nr.30/11, të datës 01.03.2018, ka shqyrtuar trashëgiminë e trashëgimlënsit ██████ dhe pas shqyrtimit dhe pas marrjes së deklaratave të pjesëmarrësve për trashëgimtar ka shpallë pjesëmarrësit, të bijtë e trashëgimlënsit ██████ me numër personal të lnj. ██████ ██████ me numër personal të lnj. ██████ ██████ me numër personal të lnj. ██████ ██████, me numër personal të lnj. ██████, dhe ██████ me numër personal të lnj. ██████ secili me nga 1/5 të pjesës ideale, në tërë pasurinë e paluajtshme të të ndjerit.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, aktvendimit T.nr.30/11, të datës 01.03.2018, gjeti se në pasuesin e tretë (3) të dispozitivit të aktvendimit gabimisht është shënuar se pjesëmarrësi [REDACTED] me numër personal të Inj. [REDACTED], e trashëgon vetëm pjesën që do t'i takonte të ndjerit [REDACTED] djali i trashëgimlënësit) po ashtu në pasuesin e parë, të tretë dhe të katërt të arsyetimit të aktvendimit gjykata gjeti se gabimisht është shënuar: emri [REDACTED] dhe duhet të jetë emri [REDACTED] si dhe gabimet e tjera të cilat janë përmirësuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me këtë aktvendim njoftohen palët dhe të njëjtëve ju dorëzohet nga një kopje.

Nga të cekurat më lart dhe në bazë të nenit 165.1, 165.2 dhe 165.4, të LPK-së, lidhur me nenin 3, të Ligjit të procedurës jokontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.


### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

T.nr.30/11, më datë 09.03.2018

**Këshilla juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa

Gjyqtari

Faton Ajvazi



REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC



Më  
Dana

09.03.2018